

FJALA E DEPUTETES EVIS KUSHI

E ENJTE 28 PRILL 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Lajmi i mirë i kohëve të fundit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ka qenë pa dyshim nënshkrimi i marrëveshjes midis qeverisë shqiptare dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin “Horizont Europa”. Është fjala për programin kuadër të Bashkimit Europian për kërkimin shkencor dhe inovacionin. Kjo marrëveshje përcakton kriteret dhe kushtet e pjesëmarrjes së Shqipërisë në këtë program, në mënyrë që të gjitha institucionet e arsimit të lartë, apo qendrat kërkimore shkencore të aplikojnë për fonde për të financuar projektet e tyre kërkimore-shkencore në partneritet me universitete apo institucione europiane.

Është lajm i mirë jo vetëm për faktin se ky është një detyrim për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, i cili buron nga kapitulli 25 “Kërkimi shkencor dhe inovacioni”, por është një lajm i mirë, sepse do të rrisë nivelin dhe cilësinë e kërkimit shkencor në institucionet tona të arsimit të lartë. Duhet ta pranojmë që konkurrenca me universitetet e huaja dhe me institucionet kërkimore të Bashkimit Europian është e lartë. Kjo do t’i detyrojë institucionet tona që të rriten në këtë nivel, në mënyrë që të konkurrojnë për të përthithur sa më shumë fonde. Ky nuk është programi i parë që Shqipëria merr pjesë, pasi ne kemi marrë pjesë edhe në programin e mëparshëm, “Horizon 2020”, për vitet 2014- 2020, por edhe programin tjetër, që është programi i shtatë kuadër për kërkimet, për vitet 2007-2013.

Po t’u referohemi statistikave, rezulton se financimi që kanë përthithur universitetet tona është rritur me 275 %. Pra, nga 2 milionë euro, që kanë thithur universitetet tona për financim në programin e shtatë kuadër për kërkimet, në programin e ri “Horizon 2020” kemi përthithur 5,5 milionë euro, pra kemi më shumë sesa dyfishim i performancës. Nga ana tjetër, më duhet të theksoj se rritja e performancës konsiston edhe në faktin se disa nga universitetet tona, ose nga institucionet që kanë aplikuar, jo vetëm që kanë fituar dhe kanë përthithur fonde, por kanë qenë edhe lider në projekte. Në fakt, kjo nuk ka qenë traditë në Shqipëri, pasi ne kemi qenë thjesht partnerë me institucionet e arsimit të lartë europian dhe

lidere kanë qenë gjithmonë ato, por, ndërkohë, në vitin 2021 ne kemi dy institucione shqiptare që janë lidere në projektet e Bashkimit European.

Kjo na bën optimistë që në programin e ri, të cilin sapo e kemi nënshkruar me Bashkimin European, performanca e institucioneve tona do të jetë akoma më e lartë. Ka edhe një arsye tjetër që na bën optimistë, që është ndërkombëtarizimi i universiteteve. Të gjitha universitetet publike dhe jopublike janë përfshirë në këtë proces dhe, tashmë, kanë lidhur marrëveshje me universitetet ndër më prestigjioze europiane. Këto partneritete do të shfrytëzohen jo vetëm për programe studimi të përbashkëta apo të dyfishta, por edhe për pjesëmarrje në projekte të përbashkëta për programin “Horizont Europa”. Tashmë, kërkimi shkencor dhe inovacioni janë prioritet. Kjo nuk reflektohet vetëm në strategjinë kombëtare të arsimit, 2021-2026, që sapo e kemi miratuar, por ne, tashmë, kemi filluar punën për dy dokumente shumë të rëndësishme, të cilat lidhen me kërkimin shkencor: i pari është strategjia për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin për vitet 2023- 2030, për të cilin është ngritur grupi i punës dhe ka filluar puna intensive dhe, i dyti është ligji i ri për shkencën.

Dua të theksoj se kemi një ligj shumë të vjetër, është ligji i vitit 1994, i cili është jashtë aktualitetit, institucionet që përmenden në atë ligj tashmë nuk ekzistojnë dhe ka ardhur koha, madje vite më parë, për një ligj të ri. Ne po punojmë bashkë me Akademinë e Shkencave dhe shumë institucione të tjera kërkimore për të miratuar ligjin e ri për shkencën. Sfidat janë të mëdha që me marrëveshjen e re me Bashkimin European, “Horizont Europa”, të rrisim kapacitetet e universiteteve tona për të përthithur sa më shumë fonde. Këtë po e bëjmë bashkë me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit. Duke u uruar shumë suksese institucioneve të arsimit të lartë dhe qendrave kërkimore shkencore, ju ftoj të gjithëve ta votojmë këtë projektligj! Faleminderit!